



ANALIZA E PERFORMANCËS VJETORE 2024

SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Misioni / Vizioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit

2. Kuadri ligjor dhe struktura organizative e DPP-së

2.1 Baza ligjore;

2.2 Struktura organizative e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror;

2.3 Akte që lidhen me veprimtarinë inspektuese, administrative dhe procedurale;

2.4 Infrastruktura, logjistika dhe realizimi i Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimit Publik për vitin 2024.

3. Verifikimi i Ankesave, hetimi administrativ dhe inspektimi

3.1 Ankesa të depozituara pranë DPP;

3.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave;

3.3 Hetimi disiplinor;

3.4 Ankime kundër vendimit të arkivimit të ankesës/hetimit disiplinor;

3.5 Propozime për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillit Përmbartimor;

3.6 Inspektimet tematike dhe inspektimet e përgjithshme;

3.7 Problematikat lidhur me mosekzekutimin e titujve ekzekutivë;

3.8 Rekomandimi i inspektimeve;

3.9 Monitorimi i rekomandimeve.

4. Bashkëpunimi ndërinstitucional kombëtar dhe ndërkombëtar

4.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë;

4.2 Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale;

4.3 Bashkëpunimi me organizatat kombëtare/ndërkombëtare dhe donatorët;

4.4 Raportimet e DPP-së në kuadër të strategjive ndërsektoriale.

5. Organizimi i Brendshëm i SHPGJSH

5.1 Drejtimi administrativ i Zyrave Vendore Përmbartimore;

5.2 Transferime të përkohshme;

5.3 Transferime të përhershme;

5.4 Rekrutimi i përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë dhe punonjësve me Kod Pune;

5.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit;

5.6 Përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove;

5.7 Procesi i vlerësimit fillestar dhe i vazhdueshëm i përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjit nr. 8./2023;

5.8 Proceset gjyqësore.

6. Trasparenca dhe marrëdhëniet me publikun

- 6.1 E drejta e informimit;
- 6.2 Kordinatori për të Drejtën e Informimit;
- 6.3 Komunikimi me masmedian;
- 6.4 Rrjetet sociale. FC/INSTA;
- 6.5 Edukimi Ligjor si mënyrë komunikimi.

7. Performanca Financiare

- 7.1 Shpenzimet buxhetore. Realizimet buxhetore;
- 7.2 Të ardhurat buxhetore.
- 7.3 Buxheti planifikuar për vitin 2025

8. Statistikat e dosjeve të ekzekutuara nga çdo përmbaues gjyqësor dhe nga çdo Zyrë Vendore Përmbaimore

- 8.1 Statistikat për çdo zyrë\Statistikat për çdo përmbaues. Mesatare e ponderuar;
- 8.2 Dosjet e mbartura ndër vite nga çdo zyrë përmbaimore;
- 8.3 Vërtetimet e detyrimeve dhe vërtetimet e pensioneve ushqimore.

9. Përmbledhje e Arritjeve për vitin 2024

10. Objektivat për vitin 2025

Lista e Shkurtimeve

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës – ASHK
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit – DPP
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR
- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit - IKMT
- Ministria e Drejtësisë – MD
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike – ASPA
- Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror - SHPGJSH
- Zyrat Përmbarimore – ZP

1. MISIONI /VIZIONI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PËRMBARIMIT

Në funksion të drejtimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, Drejtori i Përgjithshëm synon garantimin e një sistemi të zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe akteve ekzekutive që është funksional, efikas dhe në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Përmes mbikëqyrjes institucionale dhe udhëheqjes strategjike, si autoritet shtetëror angazhohet për të rritur besimin e publikut në drejtësi, për të forcuar integritetin institucional dhe për të përmirësuar aksesin e qytetarëve në një drejtësi efektive.

Në qendër të vizionit të tij qëndron ndërtimi i një shërbimi përmbarimor bashkëkohor dhe profesional, i cili vendos qytetarin në fokus të shërbimit. Kjo përfshin:

- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë përmbarimore;
- ✓ rritjen e kapaciteteve profesionale dhe etike të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë;
- ✓ forcimin e bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë dhe transparencën ndaj publikut.

Përveç ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ushtron edhe funksione të tjera në mbështetje të ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, përfshirë:

- njoftimin e akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;
- mbledhjen e detyrimeve financiare në mënyrë vullnetare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve;
- konstatimin e fakteve, sendeve apo dukurive lehtësisht të verifikueshme, pa njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve;
- shitja e sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve.

Drejtimi i institucionit është zhvilluar mbi baza të qarta të ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Objektivat e ndjekura gjatë këtij viti dhe në vijim janë në përputhje me dokumentet strategjike të miratuara nga qeveria, si:

- ✚ Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2024–2030;
- ✚ Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitur 2022 - 2026;
- ✚ Strategjia Ndërsektorale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030.

Këto dokumente nënvizojnë rolin thelbësor që shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ka në funksionimin e një sistemi drejtësie të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm.

2. KUADRI LIGJOR DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT.

2.1 BAZA LIGJORE

- Ligji 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- Ligji nr.8678 datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
- Urdhër nr. 432, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”;
- Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”;
- Udhëzimi i Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, i ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.32, datë 30.08.2018 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- Ligji nr. 92/2014 “Mbi Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”;
- Ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- Ligji nr. 9975 datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026;
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030.

2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR.

Struktura organizative e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror është ndërtuar mbi parimin e funksionalitetit dhe përgjegjshmërisë institucionale, me qëllim garantimin e një zbatimi efikas dhe të unifikuar të vendimeve gjyqësore në të gjithë territorin e vendit.

Në nivel qendror, drejtimi dhe koordinimi i përgjithshëm i veprimtarisë përmbartimore ushtrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit, i cili mbështetet nga strukturat mbështetëse tekniko-administrative, përfshirë:

- Drejtorja e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave
 - o Sektori i inspektimit;
 - o Sektori i Shqyrtimit të Ankesave;
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore;
 - o Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore;
 - o Sektori i Shërbimeve Mbështetëse;
- Sektori i Financës dhe Buxhetit;


Në nivel vendor, shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror është i organizuar në zyra vendore përmbartimore të cilat veprojnë në përputhje me juridiksionin territorial të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile. Çdo zyrë përmbartimore drejtohet nga Kryetari, i cili njëkohësisht është edhe përmbartues gjyqësor, si dhe mbikëqyr zbatimin e detyrimeve ligjore dhe përgjigjet mbi veprimtarinë administrative të zyrës vendore.

Në total, shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror në nivel vendor është i organizuar në 22 zyra vendore përmbartimore:

- Zyra Përmbartimore Tiranë;
- Zyra Përmbartimore Durrës;
- Zyra Përmbartimore Shkodër;
- Zyra Përmbartimore Elbasan;
- Zyra Përmbartimore Kavajë;
- Zyra Përmbartimore Lushnjë;
- Zyra Përmbartimore Krujë;
- Zyra Përmbartimore Kurbin;
- Zyra Përmbartimore Lezhë;
- Zyra Përmbartimore Berat;
- Zyra Përmbartimore Fier;
- Zyra Përmbartimore Vlorë;
- Zyra Përmbartimore Gjirokastrë;
- Zyra Përmbartimore Sarandë;
- Zyra Përmbartimore Përmet;
- Zyra Përmbartimore Mat;
- Zyra Përmbartimore Dibër;
- Zyra Përmbartimore Kukës;
- Zyra Përmbartimore Tropojë;

- Zyra Përmbartimore Pukë;
- Zyra Përmbartimore Pogradec;
- Zyra Përmbartimore Korçë.

ORGANIGRAMA E SHËRBIMIT PËRMBARTIMOR GJYQËSOR SHETËROR



2.3. AKTE QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË INSPEKTUESE, ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE

Gjatë vitit 2024, veprimtaria e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror është mbështetur në një kuadër rregullator që ka orientuar punën inspektuese, administrative dhe procedurale të institucionit. Zbatimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve specifike ka synuar rritjen e efikasitetit institucional, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe garantimin e standardeve të ligjshmërisë në ushtrimin e funksioneve përmbartimore.

Zbatimi i ligjit të ri organik nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, si dhe ndjekja në vijimësi e procesit të miratimit të akteve nënligjore në zbatim të tij, ka qënë një tjetër obligim thelbësor i Drejtorisë për këtë periudhë.

Ligji i ri i miratuar garanton një proces emërimi dhe promovimi të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, të bazuar në kritere transparente, objektive, meritokracie, trajtim financiar si dhe rikoncepton sistemin e trajnimit fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

Zbatimi i këtyre akteve ka sjellë një përmirësim të ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe forcimin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, janë evidentuar edhe disa sfida si mungesa e unifikimit të praktikave përmbarimore, ngarkesa e lartë e dosjeve përmbarimore, si dhe nevoja për një përditësim më të shpejtë të udhëzimeve në raport me ndryshimet ligjore. Këto elementë janë marrë në konsideratë në hartimin e prioriteteve për vitin pasardhës.

Gjithashtu, me Urdhrin nr.157 **Prot., datë 07.02.2023** të Ministrit të Drejtësisë është ngritur Grupi i Punës me perfaqesues nga MD dhe DPP për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror” dhe duke bashkërenduar punën janë miratuar:

- Urdhër nr.6 datë 30.06.2023 "Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e komandimit të përmbaruesit gjyqësor".
- Urdhër nr.432 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbytjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”.
- Urdhër nr. 475 datë 20.07.2023 “Për miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë”.
- Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbytjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove”.
- Urdhër nr.447, datë 10.07.2023 “Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbaruesve gjyqësorë të shërbimit të përmbarimit gjyqësor shtetëror”.
- Urdhër nr.434 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave me të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”.

Për vitin 2024 janë miratuar aktet nënligjore si vijon:

- Udhëzimi i përbashkët nr.3 datë 16.04.2024, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë nga Policia e Shtetit”;
- Urdhri nr.333, datë 18.06.2024 “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë”;
- Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror”.
- Urdhër nr. 167, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Përmbarimor”;
- Udhëzimi nr. 1, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përmbaruesit gjyqësor shtetëror”.
- Urdhër nr.334 datë 18.06.2024 “Për miratimin e marrëveshjes tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga shërbimi përmbarimor shtetëror”.

P.s. ende nuk janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të parashikuara në nenin 93 të ligjit nr. 8/2023. Mungojnë aktet e parashikuara në nenin 31, 36, të ligjit 8/2023 Rregullorja e brendshme e institucionit dhe metodologjia e inspektimit.

2.4 Infrastruktura, logjistika dhe realizimi i Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimit Publik për vitin 2024.

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror pas shkëputjes nga gjykatat trashëgoi një infrastrukturë të mjerueshme, pasojat e të cilës ndjehen dhe në veprimtarinë përmbartimore. Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka probleme evidente me mungesën e ambienteve të zyrave. Shpesh herë janë bërë dhe emisione investigative mbi problematiken infrastrukture në zyrat vendore përmbartimore, si rasti i Kavajës.

Shërbimi përmbartimor fillimisht është vendosur në ambientet e ish - gjykatave të rretheve gjyqësore respektive, prokurorisë dhe zyrave të marra me qera dhe konkretisht:

- Zyra Dibër, Krujë, Kukës, Lezhë, Pukë, Fier, Shkodër, Tropojë, dhe Pogradec ndodhen në ambientet e gjykatave sipas rretheve respektive;
- Zyra e Matit është e akomoduar në ambiente të Bashkisë Mat;
- Zyra e Korçës është e sistemuar në ambientet të ish- Bashkisë Korçë;
- Zyra Sarandë dhe Berat është e akomoduar në ambiente të marra me qera përmes procedurave të prokurimit publik;
- Zyra Përmbartimore Elbasan është e akomoduar në ambiente shtetërore në administrim të Bashkisë Elbasan, të cilat janë të papërshtatshme për të garantuar shërbim korrekt për qytetarët;
- Zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, Zyrës Përmbartimore Tiranë, Durrës, Kurbin dhe Vlorë janë në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, por secila nga zyrat vendore ka problematikë të theksuar infrastrukture dhe llogjistike.

Problem shqetësues për zyrat e sistemuara në ambientet e gjykatave ka qenë dhe mbetet jo vetëm kërkesat nga ana e gjykatave për largimin e përmbartimit nga ambientet e këtyre godinave, por edhe ambiente të pamjaftueshme dhe në gjendje të mjerueshme për ushtrim aktiviteti në kushte optimale, por në pamundësi sistemimi, kanë vazhduar të qëndrojnë në këto ambiente.

Për gjatë vitit 2024 është mundësuar sistemimi me ambiente të përshtatshme të zyrave vendore përmbartimore, si më poshtë:

- Zyra Përmbartimore Gjirokastrë është sistemuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë në ambientet e ish-godinës së Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;
- Zyra Përmbartimore Korçë është sistemuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë në ambientet e ish - godinës së Gjykatës së Apelit Korçë;
- Zyra Përmbartimore Lushnjë, me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë si dhe procedurës së ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme është sistemuar në ambiente të marra me qera;

- Po ashtu edhe Zyra Përmbartimore Durrës me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë si dhe procedurës së ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme është sistemuar në ambiente të marra me qera.

Sistemimi i zyrave vendore përmbartimore është dhe mbetet prioritet në ndjekje të institucionit të Drejtësisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Gjendja e logjistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit dhe në zyrat vendore përmbartimore paraqet vështirësi serioze për garantimin e një pune të qëndrueshme dhe efikase. Pjesa më e madhe e pajisjeve kompjuterike është jashtë standarteve të nevojshme për funksionimin normal: kompjuterët janë të vjetëruar dhe funksionojnë me vështirësi, ndërsa problemet e përsëritura me domain dhe rrjetin, veçanërisht gjatë aktivizimit të WIFI, ndikojnë negativisht në aksesin në sistemet digjitale.

Mjetet për skanim dhe fotokopjim janë të pamjaftueshme dhe në pjesën më të madhe të rasteve jashtë funksioni. Infrastruktura elektrike është në gjendje të amortizuar dhe paraqet rrezik për dëmtime në pajisje dhe ndërprerje të aktivitetit, veçanërisht në raste mbingarkese. Prokurimi i fundit për pajisje elektronike në DPP është bërë në vitin 2019.

Gjithashtu, pajisjet e kondicionimit janë jashtë funksionit, duke e bërë të vështirë punën në periudha me temperatura të larta ose të ulëta.

Përveç problematikës infrastrukturale dhe llogjistike, problem tjetër është mos kryerja në mënyrë periodike e shërbimeve të flotës së makinave të shërbimit përmbartimor. Të gjitha këto shqetesime i janë bërë me dije Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit pas kërkesës së këtij të fundit.

Këto kushte e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen e menjëhershme për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve bazë për zhvillimin normal të funksioneve institucionale.

Sistemimi i zyrave vendore përmbartimore është dhe mbetet prioritet në ndjekje të institucionit të Drejtësisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Me miratimin e hartës së re gjyqesore në vitin 2023 dhe udhëzimeve të Ministrit të Drejtësisë në ambientet e ish-gjykatave është menduar të sistemohen institucionet e varësisë së MD-së.

Prokurimet Publike

❖ Për sa i përket pjesëmarrjes në njësin e prokurimit

Njësia e prokurimit (Antoneta Palaj , Fatmira Seferaj) kanë pasur të planifikuara katër procedura dhe janë realizuar katër procedura:

1. Kërkesë për kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit me objekt “Blerje e 1 (një) mjeti transporti ”, për vitin 2024 , për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit.
2. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel(Gazoil)”
Fondi limit për këtë procedurë është 3,774.000 lekë.
3. “Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benine pa plumb”
Fondi limit për këtë procedurë është 1,142,400 lekë.
4. Siguria dhe ruajtja e Institucionit nga Ilyria Guard.

❖ **Komision i blerjeve të vogla (Irma Asllanaj, Anxhela Gashi, Fatmira Seferaj), janë realizuar :**

Procedurë blerje me vlera të vogla & blerje nën 100,000lekë:

1. “Siguracion TPL dhe KASKO, për automjetet e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”;
2. Blerje shërbimi për larjen e Automjetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, tip “MERCEDES BENZ” me targë AA748VA;
3. Blerje Material Pastrimi për Pastrimin e Ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
4. Blerje Abonim në zgjidhjen softëare-ike për kryerjen e proceseve të fiskalizimit, për 12 muaj, për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe 21 Zyra Përmbarimore Vendore;
5. Kontrolli dhe evidentimi i problemeve të Automjetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit AA748VA, për riparimin të defekteve të shfaqura;
6. Pjesë Këmbimi, Goma, Bateri për automjetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
7. Mirëmbajtje mjete transporti për automjetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
8. Larje tapeti, rrugicës së koridorit dhe perdeve “të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
9. Blerje ndriçues për Ambientet e Institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit;
10. Shpenzime për transferimin e Zyrës Përmbarimore Gjirokastër.

Arritjet

- ✓ Është kryer regjistrimi i 21 Zyrave Vendore Përmbarimore si njësi shpenzuese pranë Drejtorive Rajonale Tatimore Vendore, duke u pajisur me certifikatë regjistrimi (NIPT).

Nga 01 Janari i vitit 2025 të gjitha zyrat vendore përmbarimore do të funksionojnë si njësi shpenzuesemë vete.

3. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI ADMINISTRATIV DHE INSPEKTIMI

3.1 Ankesa të depozituara pranë DPP-së

Duke ju përmbajtur objektivit të veprimtarisë së saj, Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave është përballur me një volum të madh pune për vitin 2024. Veprimtaria e kësaj Drejtorie në mënyrë të përmbledhur ka qënë e orientuar:

- Në trajtimin korrekt dhe brenda afateve të **331** ankesave të paraqitura/regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit për vitin 2024, dhe trajtimin korrekt dhe brenda afateve të **97** ankesave të përcjella nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes. Kjo procedurë i ka shërbyer përpjekjeve për të siguruar së *pari*, promovimin e përgjegjshmërisë së strukturave që menaxhojnë Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, të cilat, të gjendura përballë mundësisë së shqyrtimit të procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, natyrshëm, kanë patur prirjen të veprojnë me profesionalizëm dhe integritet, dhe, së *dyti* dhënien e përgjigjeve në kohë dhe të efektshme të ankesave, që të shërbejë jo vetëm në identifikimin dhe parandalimin e shkeljeve procedurale në të ardhmen, por edhe rritjes së besimit ndaj Strukturave të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

3.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave

Nga Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave janë shqyrtuar dhe verifikuar ankesat e përcjella pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, në përputhje me Ligjin nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, Kreu XI “procedimi disiplinor”– sipas së cilës rregullohet mënyra e verifikimit dhe shqyrtimit të ankesave ndaj veprimtarisë procedurale dhe administrative të përmbartuesve gjyqësorë shtetëror, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Në vijim të shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave janë ndjekur brenda afateve respektive të parashikuara në ligjin organik procedurat si më poshtë:

- Njoftimi dhe vënia në dijeni e ankuesit apo institucionit publik mbi fillimin e verifikimit të ankesës.
- Kërkesë për informacion dhe kopje e praktikës përmbartimore të ndjekur për ekzekutimin e çështjes, objekt anekse, me qëllim kryerjen e hetimit administrativ të saj, drejtuar zyrës vendore përmbartimore.
- Relacion mbi shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës si dhe propozimet përkatëse mbi fillimin e hetimit disiplinor apo arkivimin e ankesës.
- Vendim për arkivimin e ankesës apo fillimin e hetimit disiplinor.
- Kthim përgjigje ankuesit mbi shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës si dhe njoftimin mbi vendimin e arkivimit të ankesës apo të fillimit të hetimit disiplinor.
- Urdhër për pezullim hetimi disiplinor në rastet që parashikon neni 69 i Ligjit 8/2023.
- Raport hetimi disiplinor si dhe propozimet mbi arkivimin e ankesës ose fillimit e procedimit disiplinor.
- Njoftimi i palëve si dhe dërgim i raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë Këshillit Përmbartimor.

Gjithashtu, është organizuar, në zbatim të urdhrave të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm, pritja e personave fizikë dhe juridikë, të cilët kanë paraqitur ankesat e tyre verbalisht pranë Drejtorisë.

3.3 Hetimi disiplinor

Për vitin 2024, në bazë të verifikimit të shqyrtimit të ankesave, nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit është vendosur fillimi i hetimit disiplinor për 3 përmbarruesë gjyqësorë shtetërorë, si dhe në zbatim të nenit 69 të Ligjit nr. 8/2023 « Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror » është urdhëruar pezullimi i hetimeve disiplinore për shkak se përmbarruesit gjyqësorë janë në procedime civile, penale dhe administrative, pranë gjykatave kompetente.

Për dy përmbarrues gjyqësorë shtetërorë është marrë Vendim për fillimin e hetimit administrativ, të cilat pas verifikimit të kryer dhe vënien në dispozicion të dokumentacionieve të kërkuara, është vendosur nga Drejtori i Përgjithshëm arkivimi i ankesës.

3.4 Ankime kundër vendimit të arkivimit të ankesës/hetimit disiplinor

Për vitin 2024, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit nuk është depozituar asnjë ankesë kundër vendimit të arkivimit të ankesës apo vendimit të fillimit të hetimit disiplinor ndaj një përmbarruesi gjyqësor shtetërorë.

3.5 Propozime për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillit Përmbarrimor

Për vitin 2024, nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit nuk është përcjellë asnjë propozim për procedim disiplinor para Këshillit Përmbarrimor, pasi hetimet disiplinore kanë qenë të pezulluara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, në zbatim të nenit 69 të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”.

Gjithashtu, sjellim në vëmendje se:

- ❖ Në Akt – kontroll nr. 1755/1 Prot., datë 22.12.2023, mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të përmbarruesit gjyqësor/ Kryetar Dritan Nika pranë Zyrës Përmbarrimore Mat ndër të tjera janë gjetur shkeljet si më poshtë:
 1. Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbarruesit gjyqësor shtetëror.
 2. Mospërbushja në mënyrë të qëllimshme dhe të pajustificuar të detyrave, që i caktohen përmbarruesit gjyqësor shtetëror.
 3. Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbarrimore.
 4. Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

Për sa më sipër, në bazë të nenit 67, e vijues të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror” është propozuar fillimi i hetimit disiplinor për shkeljet e gjetura të lartpërmendura, si dhe fillimin e procedimit disiplinor për masën disiplinore **“largim nga detyra”** ndaj përmbaruesit gjyqësor njëkohësisht Kryetar i Zyrës Përmbarimore Dritan Nika.

Për këto arsye, me vendimin Nr.145 Prot., Nr. 2, datë 18.01.2024, “Për fillimin e hetimit disiplinor për përmbaruesin gjyqësor Dritan Nika, pranë Zyrës Përmbarimore Mat”, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit, në mbështetje të nenit 8, nenit 67 të Ligjit Nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, ka vendosur:

Fillimin e hetimit disiplinor për përmbaruesin gjyqësor/Kryetar Dritan Nika, pranë Zyrës Përmbarimore Mat. Objekt i hetimit disiplinor është:

- Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor shtetëror.
- Mospërbushja në mënyrë të qëllimshme dhe të pajustificuar të detyrave, që i caktohen përmbaruesit gjyqësor shtetëror.
- Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbarimore.
- Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

❖ Në akt-kontrollin Nr. 143 Prot., datë 17.01.2024, bazuar në inspektimin e kryer konform Urdhërit nr. 1972 Prot., Nr. 117, datë 17.11.2023 “Për ushtrimin e kontrollit periodik mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative në Zyrën Përmbarimore Berat”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, për përmbaruesin gjyqësor, njëkohësisht kryetar i Zyrës Përmbarimore Berat Ilir Çipi, janë evidentuar shkelje e gjetura si më poshtë:

- Mospërbushja me faj e veprimeve përmbarimore të parashikuara në ligj, që kanë cënuar të drejtat e palëve në proces ekzekutimi.
- Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor shtetëror.
- Mospërbushja në mënyrë të qëllimshme dhe të pajustificuar të detyrave, që i caktohen përmbaruesit gjyqësor shtetëror
- Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbarimore.
- Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

Për këto arsye, Grupi i Kontrollit, pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, mbështetur në nenin 74, pika 3, germa e), 85 pika 1, germa a), c), d), e), ë), h), 86 pika 1, germa d), të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, pasi shqyrtoi çështjen në terësi, propozojë:

1. Fillimin e procedimit disiplinor për masën disiplinore **“largim nga detyra”** ndaj përmbauesit gjyqësor Ilir ÇIPI, pranë Zyrës Përmbaimore Berat.

- ❖ Në akt-kontrollin Nr. 143 Prot., datë 17.01.2024, bazuar në inspektimin e kryer konform Urdhërit nr. 1972 Prot., Nr. 117, datë 17.11.2023 “Për ushtrimin e kontrollit periodik mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative në Zyrën Përmbaimore Berat”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbaimit, për përmbauesin gjyqësorë pranë Zyrës Përmbaimore Berat Armando Cjapi janë evidentuar shkelje e gjetura:
- Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor shtetëror.
 - Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbaimore.
 - Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

Për sa më sipër, Grupi i Kontrollit, pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit, mbështetur në nenin 74, pika 3, gërma e), 85 pika 1, gërma a), e), 86 pika 1, gërma b), të Ligjit Nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror”, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, propozoi **“Fillimin e procedimit disiplinor për masën disiplinore *“vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”*, ndaj përmbauesit gjyqësor, pranë Zyrës Përmbaimore Berat, Armando Cjapi”**.

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbaimit me shkresën Nr. 282/1 Prot., datë 24.04.2024, “Raport hetimi disiplinor për përmbauesin gjyqësor pranë Zyrës Përmbaimore Berat, Armando Cjapi”, ka urdhëruar ushtrimin e një kontrolli tjetër për sa i përket konstatimeve dhe rekomandimeve që ka lënë grupi i kontrollit të DPP-së.

Me shkresën Nr. 283/2 Prot., datë 24.04.2024, “Mbi shkresën Nr. 282/1 Prot., datë 24.04.2024, si dhe Nr. 283/1 Prot., datë 24.04.2024, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave”, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbaimit, në kushtet kur për plotësimin e rekomandimeve të sugjeruara nga ana e grupit të inspektimit të përcaktuar në Urdhrin Nr. 1972 Prot., Nr. 117, datë 17.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbaimit, përmbauesi gjyqësor përgjegjës duhet të zbatojë afatet procedurale konform Kodit të Procedurës Civile, ka pranuar kryerjen e Inspektimit pranë Zyrës Përmbaimore Berat në periudhën e përcaktuar në Planin e Punës Nr. 34 Prot., datë 05.01.2024, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

Në inspektimin e kryer është konstatuar se nga ana e përmbauesit gjyqësor pranë Zyrës Përmbaimore Berat, Armando Cjapi në dosjet e inspektuara janë zbatuar rekomandimet e bëra nga grupi i inspektimit në akt-kontrollin Nr. 143 Prot., datë 17.01.2024.

Për këto arsye, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbaimit, në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror”, me vendimin Nr. 29/1 prot., datë 07.01.2025 Vendosi:

-Mbyllet hetimi disiplinor për përmbauesin gjyqësor, pranë Zyrës Përmbaimore Berat, Armando Cjapi.

- ❖ Në akt-kontrollin Nr. 143 Prot., datë 17.01.2024, bazuar në inspektimin e kryer konform Urdhërit Nr. 1972 Prot., Nr. 117, datë 17.11.2023 “Për ushtrimin e kontrollit periodik mbi veprimtarinë procedurale dhe

administrative në Zyrën Përbarimore Berat”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përbarimit, për përbaruesin gjyqësor pranë Zyrës Përbarimore Berat Julian Plaka janë evidentuar shkelje e gjetura:

- Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor shtetëror.
- Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përbarimore.
- Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

Për sa më sipër, Grupi i Kontrollit, pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit, mbështetur në nenin 74, pika 3, gërma e), 85 pika 1, gërma a), e), ë), 86 pika 1, gërma b), të Ligjit Nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, propozoi “Fillimin e procedimit disiplinor për masën disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”**, ndaj përbaruesit gjyqësor, pranë Zyrës Përbarimore Berat, Julian Plaka”.

Drejtori i Përgjithshëm i Përbarimit me shkresën Nr. 283/1 Prot., datë 24.04.2024, “Raport hetimi disiplinor për përbaruesin gjyqësor pranë Zyrës Përbarimore Berat, Armando Cjapë”, ka urdhëruar ushtrimin e një kontrolli tjetër për sa i përket konstatimeve dhe rekomandimeve që ka lënë grupi i kontrollit të D.P.P. -së.

Me shkresën Nr. 283/2 Prot., datë 24.04.2024, “Mbi shkresën Nr. 282/1 Prot., datë 24.04.2024, si dhe Nr. 283/1 Prot., datë 24.04.2024, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave”, Drejtori i Përgjithshëm i Përbarimit, në kushtet kur për plotësimin e rekomandimeve të sugjeruara nga ana e grupit të inspektimit të përcaktuar në Urdhrin Nr. 1972 Prot., Nr. 117, datë 17.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përbarimit, përbaruesi gjyqësor përgjegjës duhet të zbatojë afatet procedurale konform Kodit të Procedurës Civile, ka pranuar kryerjen e Inspektimit pranë Zyrës Përbarimore Berat në periudhën e përcaktuar në Planin e Punës Nr. 34 Prot., datë 05.01.2024, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

Në inspektimin e kryer është konstatuar se nga ana e përbaruesit gjyqësor pranë Zyrës Përbarimore Berat, Julian Plaka në dosjet e inspektuara janë zbatuar rekomandimet e bëra nga grupi i inspektimit në akt-kontrollin Nr. 143 Prot., datë 17.01.2024.

Për këto arsye, Drejtori i Përgjithshëm i Përbarimit, në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”, me vendimin Nr. 28/1 prot., datë 07.01.2025 Vendosi:

-Mbylljen e hetimit disiplinor për përbaruesin gjyqësor, pranë Zyrës Përbarimore Berat, Julian Plaka.

❖ Gjithashtu, në akt-kontrollin Nr. 417 Prot., datë 23.02.2024, për përbaruesin gjyqësor Klevis Cake pranë Zyrës Përbarimore Pogradec janë evidentuar shkeljet e gjetura:

1. Shkelje e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor shtetëror.

2. Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbartimore.
3. Pakujdesi në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës.

Në bazë të ligjit Nr. 8/2023, datë 02.02.2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror”, si dhe shkresës Nr. 539/1 Prot., datë 20.05.2024, “Raport hetimi disiplinor për përmbartuesin gjyqësor, pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec, Klevis Cake”, ku në bazë të shkeljeve të gjetura të sipërcituara, grupi i Kontrollit, pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, si dhe mbështetur në nenin 74, pika 3, gërma e), 85 pika 1, gërma a), e), ë), 86 pika 1, gërma a), të Ligjit Nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, ka propozuar, “Fillimin e procedimit disiplinor për masën disiplinore **“vërejtje”** ndaj përmbartuesit gjyqësor pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec, Z. Klevis Cake”.

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit me shkresën Nr. 539/1 Prot., datë 20.05.2024, “Raport hetimi disiplinor për përmbartuesin gjyqësor pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec, Klevis Cake”, ka urdhëruar ushtrimin e një kontrolli tjetër për sa i përket konstatimeve dhe rekomandimeve që ka lënë grupi i kontrollit.

Me shkresën Nr. 539/2 Prot., datë 20.05.2024, “Mbi shkresën Nr. 539/1 Prot., datë 20.05.2024 të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave”, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit, në kushtet kur për plotësimin e rekomandimeve të sugjeruara nga ana e grupit të inspektimit të përcaktuar në Urdhrin Nr. 2015 Prot., Nr. 126, datë 04.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit, përmbartuesi gjyqësor përgjegjës duhet të zbatojë afatet procedurale konform Kodit të Procedurës Civile, ka pranuar kryerjen e Inspektimit pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec në periudhën e përcaktuar në Planin e Punës Nr. 34 Prot., datë 05.01.2024, të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

Është konstatuar se përmbartuesi gjyqësor pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec, Klevis Cake, në dosjet përmbartimore të inspektuara ka zbatuar rekomandimet e bëra nga ana e grupit të inspektimit në Akt-kontrollin Nr. 417 Prot., datë 23.02.2024, bazuar në inspektimin e kryer konform Urdhërit Nr. 2015 Prot., Nr. 126, datë 04.12.2023 “Ushtrimin e kontrollit periodik mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative në Zyrat Përmbartimore Korçë, Pogradec dhe Elbasan”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit.

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit, në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, Vendosi:

1. Mbyllet hetimi disiplinor për përmbartuesin gjyqësor, pranë Zyrës Përmbartimore Pogradec, Klevis Cake.

3.6 Inspektimet tematike dhe inspektimet e përgjithshme

Në kuadër të përmirësimit të programit të kontrollit mbi veprimtarinë procedurale, administrative dhe financiare të Shërbimit, me qëllim monitorimin dhe kontrollin e procedurave përmbarimore të ndjekura, Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave pranë DPP-së, ka miratuar Planin e Inspektimit Nr. 34 Prot., datë 05.01.2024 dhe ka ushtruar kontroll periodik dhe në bazë ankese në 22 Zyrat Vendore Përmbarimore, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Plani i inspektimit ka pasur në objekt:

- Trajtimin e ankesave/kërkesave të personave fizikë dhe juridikë, të ardhura pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit si shkresërisht ashtu dhe elektronikisht.
- Procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përmbarimore si:
 - Respektimi i afateve të arsyeshme ligjore dhe kryerja në kohë e veprimeve procedurale në ekzekutimin e titujve ekzekutivë.
 - Zbatimi në mënyrë rigoroze e neneve 615/616 të Kodit të Procedurës Civile për pezullimin/pushimin e dosjeve përmbarimore.
 - Administrimi në mënyrë korrekte e të gjitha akteve të prodhuara në funksion të ekzekutimit të titulli ekzekutiv, në dosjen përmbarimore.
 - Hetimi i plotë administrativ drejtuar të gjithë institucioneve përkatëse për gjetjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të debitorit.
 - Vënia në ekzekutim e urdhrat të ekzekutimit në zbatim të nenit 515 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
 - Regjistrimi për ekzekutim i titujve ekzekutiv me objekt- urdhër mbrojtje/urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes, si dhe marrja e masave të menjëhershme në ekzekutimin me përparësi të tyre në zbatim rigoroz të dispozitivit të gjykatës dhe legjislacionit në fuqi.
 - Firmosja dhe vulosja me vulën e institucionit e të gjitha akteve përmbarimore të nxjerra në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.
 - Njoftimi i palëve në proces ekzekutimi për të gjitha veprimet përmbarimore të ndjekura nga përmbaruesi gjyqësor përgjegjës.
 - Aktet përmbarimore të nxjerra për kërkimin e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të palës debitore, drejtuar institucioneve përkatëse, të jenë individuale për çdo dosje përmbarimore dhe jo për disa çështje përmbarimore në një shkresë.
 - Nëse janë të regjistruara në librat e protokollit apo regjistrat të mbajtura nga përmbaruesi gjyqësor, për regjistrimin e urdhrave të ekzekutimit, të gjitha numrat e protokollit dhe datat e vendosura në shkresat procedurale të nxjerra në funksion të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
 - Shkresat procedurale të nxjerra nga përmbaruesi gjyqësor të jenë në formatin zyrtar të aprovuar.
 - Respektimi në mënyrë rigoroze i dispozitivit të Gjykatës, në ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv.
 - Të gjitha aktet procedurale përmbarimore të përpiluara nga përmbaruesi gjyqësor, të jenë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, si dhe Komentarin – Udhëzues “Mbi Modularët e Unifikuar të Veprimtarisë Procedurale të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor” /2004.
 - Kontrolli i librave regjistër-protokoll, nëse janë pasqyruar të gjitha shkresat hyrëse dhe dalëse të Institucionit.
 - Kushtet e mbajtjes së Arshivës së Zyrës Përmbarimore.

- Respektimi i afateve në vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, nga data e dorëzimit të kërkesës për ekzekutim nga kreditori, përcaktuar në nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile.
- Administrimi nga ana e zyrës përbarimore të vulës së institucionit, si dhe vulës së protokollit.
- Arshivimi i dosjeve përbarimore që janë pushuar si të ekzekutuara tërësisht, duke u bërë veprimet përkatëse nga sekretaria.

- Njohja dhe zbatimi i Kodit të Etikës, bazuar në Urdhrin e Ministrit nr.3851, datë 08.05.2009, “Për miratimin e Kodit të Etikës, të Përbaruesve Gjyqësorë, Shtetërorë dhe Privatë”, paraqitja në punë, komunikimi me qytetarët, si dhe ngarkesa ditore e secilit përbarues.
- Zbatimi i kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, urdhrave dhe udhëzimeve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit dhe akteve të tjera nënligjore, në respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit, për dosjet përbarimore.
- Zbatimi i rekomandimeve të bëra nga grupi i inspektimit pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, në Akt- Kontrollin e përcjella pranë Zyrave Vendore Përbarimore.

Në akt kontrollet përkatëse janë nxjerrë konkluzionet për secilën zyrë të inspektuar duke evidentuar shkeljet e gjetura, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për përmirësim të veprimtarisë së ekzekutimit.

3.7 Problematikat lidhur me mosekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Referuar akt - kontrolleve nga Grupi i Inspektimit sa i përket inspektimeve të kryera për verifikimin e veprimtarisë procedurale dhe administrative të përbaruesve gjyqësorë shtetërorë në 22 Zyra Vendore Përbarimore, rezultojnë ndër të tjera konstatimet si më poshtë:

- Mosrespektim i afateve të arsyeshme ligjore në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, dhe tejkalim të afateve, për shkak të moskryerjes në kohë të veprimeve procedurale.
- Hetimi jo i plotë dhe i pamjaftueshëm administrativ, lidhur me shtrirjen në kohë të kërimit dhe gjetjes së pasurive të debitorit.
- Mosadministrim në dosjen përbarimore i shkresës “Urdhër mbi Vënien e Taksës”.
- Veprime procedurale jo të plotë mbi gjetjen e adresës së saktë të palës debitore, me qëllim njoftimin mbi procedurat përbarimore.
- Mosadministrim i të gjitha akteve procedurale në dosjen përbarimore.
- Mosnjoftim i palëve kreditore dhe debitore mbi të gjitha procedurat përbarimore të ndjekura nga përbaruesi gjyqësor mbi ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit.

- Në dosjet përmbaremore të inspektuara shkresat e prodhuara nga përmbareuesi gjyqësor në funksion të ekzekutimit të Titulli Ekzekutiv kanë numra protokolli dhe datë të njëjtë.
- Shkresat e përpiluara nga ana e përmbareuesit gjyqësor në funksion të ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv, kanë gabime materiale, lidhur me gjeneralitetet e debitorit dhe shumën, kur objekti është “kthim shume”.

Gjatë ushtrimit të kontrolleve periodike si dhe atyre të ushtruara në bazë ankese apo edhe gjatë shqyrtimit të ankesave të përcjella në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbareimit përveç sa thamë më sipër është konstatuar se një numër i lartë i titujve ekzekutivë kanë mbetur pa ekzekutuar ose pa marrë zgjidhje ligjore për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe ofrimit të mbështetjes nga instiucionet që kanë detyrim ligjor që ta ofrojnë si vijon.

- Agjencitë Rajonale të Kadastrës, të cilat refuzojnë vënien e masës së sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme të rezultuara në pronësi të debitorëve.
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, gjithashtu, me pretendime të pabaza administrative, nuk zbatojnë masat e sekuestrove të përmbareuesve gjyqësorë dhe nuk ofrojnë informacionin e kërkuar mbi pasuri të luajtshme që mund të rezultojnë në emër të debitorëve.
- Nga ana e Institutit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit nuk vendosen në dispozicion mjetet dhe forcë punëtore për shkak të angazhimeve të mjeteve në përmbushje të detyrave funksionale të institucionit, duke shkaktuar zvarritje të procedurave për ekzekutim të titujve ekzekutivë me objekt “*lirim dorëzim*”, “*prishje objekti*”, etj.
- Problematikë në ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt pension ushqimor paraqet vështirësi në verifikimin e të ardhurave që siguron prindi debitor, i cili nuk ka fëmijën në ngarkim, por që duhet të paguajë detyrimin për ushqim. Kjo ndodh për faktin se një numër i konsiderueshëm personash nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre sipas kërkesave të ligjit, ose nuk kanë lidhur kontratë për punën që kryejnë dhe nuk u rezulton asnjë e ardhur apo pasuri qoftë e luajtshme apo e paluajtshme në emër të tyre. Sigurisht, që kjo ka çuar në pamundësinë për të realizuar shlyerje të detyrimit për shumë prej këtyre çështjeve dhe mos siguruar zbatimin e vendimit gjyqësor.
- Paaftësia paguese për psikologun, në dosjet me objekt « takim fëmije », është një nga ankesat e shumta të paraqitura nga palët gjatë procesit të ekzekutimit, duke u shprehur se e kanë të pamundur të paguajnë kosto financiare për asistimin e psikologut gjatë takimeve të fëmijëve që refuzojnë t’i takojnë prindërit e tyre.
- Paaftësia paguese për ekspertët e nevojshëm gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, në pjesën më të madhe të ankesave, rezulton se palët deklarojnë se kanë pamjaftueshmeri financiare për të kryer parapagimet e shpenzimeve përmbaremore, sipas dispozitave të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.

3.8 Rekomandime nga Inspektimet.

Bazuar në planin Nr. 34 Prot., datë 05.01.2024 të Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave për periudhën Janar - Dhjetor 2024, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit janë ushtruar inspektime në 22 Zyrat Vendore Përmbartimore, ku në mënyrë të përmblodhur janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Të respektohet procedura përmbartimore për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutivë bazuar në nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të korigjohen në çdo rast të konstatimit të mangësive të tyre.
- Të administrohen në dosjen përmbartimore të gjitha aktet procedurale të prodhuara nga ana e përmbartuesit gjyqësor në funksion të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
- Të respektohen afatet ligjore në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.
- Të verifikohen titujt ekzekutivë që janë regjistruar pranë Zyrave Vendore Përmbartimore, me objekt - gjobë penale, nëse këto të fundit përfitojnë nga Ligji Nr. 33/2024, datë 04.04.2024, “Për Dhënie Amnistie”, dhe përmbartuesi gjyqësor përgjegjës t’i drejtohet prokurorive përkatëse nëse pala debitoare përfiton nga amnistia.
- Të ndiqen procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile për njoftimin e palës debitoare, saktësisht, Kreu IV “Njoftime”.
- Të gjitha aktet procedurale përmbartimore të përpiluara nga përmbartuesi gjyqësor, duhet të jenë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Komentari – Udhëzues “Mbi Modularët e Unifikuar të Veprimtarisë Procedurale të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor”, dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
- Shkresat e përpiluara nga ana e përmbartuesit gjyqësor përgjegjës, në funksion të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të hartohen sipas dispozitave përkatëse për hartimin e dokumentave zyrtare.
- Regjistrimi i të gjitha shkresave hyrëse dhe dalëse në Librat e Protokollit dhe Librat e Regjistrimit Themeltar të mbajtuara pranë Zyrave Vendore Përmbartimore.

3.9 Monitorimi i rekomandimeve

Gjatë vitit 2024, një ndër pikat kyçe të objektit të ushtrimit të kontrollit ka qenë monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e mëparshme. Ky proces është ndjekur me përparësi, me qëllim vlerësimin e nivelit të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara dhe nxitjen e përmirësimeve të vazhdueshme në punën e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Rezultatet tregojnë një angazhim në rritje të zyrave vendore përmbartimore për të reflektuar mbi gjetjet e inspektimeve dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese konkrete, në funksion të forcimit të zbatueshmërisë së ligjit dhe standardizimit të praktikave.

Për më tepër, edhe gjatë vitit 2025, monitorimi i rekomandimeve mbetet pjesë integrale e objektit të kontrollit, duke vijuar si një komponent i domosdoshëm për garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë.

4.BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

4.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

Gjatë vitit 2024, bashkëpunimi institucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe Ministrisë së Drejtësisë është thelluar dhe konkretizuar në disa drejtime. Në bashkëpunim me këtë ministri janë hartuar dhe miratuar disa akte nënligjore të rëndësishme, të cilat kanë shërbyer për përmirësimin dhe standardizimin e veprimtarisë përmbarrimore.

Gjithashtu, nga Ministria e Drejtësisë janë përcjellë pranë DPP-së për trajtim ankesat e paraqitura nga palët ndaj veprimeve përmbarrimore të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë, të cilat janë shqyrtuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit ka vijuar gjithashtu raportimin periodik pranë Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe koordinimit të veprimtarisë institucionale.

Nuk ka pasur bashkëpunim me shoqërinë civile, organizatat nderkombëtare ose donatorët për vitin 2024.

4.2 Bashkëpunimi i Zyrave Vendore Përmbarrimore me institucionet qendrore dhe lokale

Zyrat Vendore Përmbarrimore gjatë vitit 2024 kanë kërkuar bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe vendore, me qëllim zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera ekzekutive. Megjithatë, në shumë raste është evidentuar mungesë bashkëpunimi apo vështirësi të përsëritura nga disa institucione.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka zbatuar urdhrat e sekuestros dhe dhënien e informacionit pasi ASHK kërkon aplikimin online në e – Albania kundrejt tarifës përkatëse, ndërsa Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk zbaton urdhrat e sekuestros pasi pretendon që nuk është më organi kompetent dhe prej një urdhri të brendshëm nuk regjistron më sekuestrot. Shpeshherë nuk kanë përcjellë informacion e kërkuar, duke e kushtëzuar atë me pagesë, gjë që bie ndesh me natyrën urgjente dhe ligjore të veprimeve përmbarrimore.

Gjithashtu, është konstatuar mungesë bashkëpunimi nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për ekzekutimin e dosjeve përmbarrimore me objekt “lirim dorëzim sendi”, si dhe nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive, të cilat shpesh nuk paraqiten në takimet e përcaktuara për realizimin e takimeve të detyruara midis fëmijës dhe prindit, sipas vendimeve gjyqësore.

Këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt në zvarritjen e ekzekutimit të vendimeve dhe çenojnë parimin e shtetit të së drejtës, duke kërkuar ndërhyrje dhe koordinim më të fortë institucional në vijim.

Referuar raportimit të kryer nga 22 Zyrat Vendore Përmbarrimore në lidhje me numrin e sekuestrove konservative të pazbatuara nga ASHK dhe DPSHTRR, për periudhën Janar – Dhjetor 2024 ka rezultuar si më poshtë, vijon:

1-Zyra Përmbarrimore Shkodër informon se për **509** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

- 2-**Zyra Përmbarimore Kavajë** informon se për **90** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 3-**Zyra Përmbarimore Berat** informon se për **415** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 4-**Zyra Përmbarimore Lushnjë** informon se për **673** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 5-**Zyra Përmbarimore Kurbin** informon se për **300** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 6-**Zyra Përmbarimore Mat** informon se për **50** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 7-**Zyra Përmbarimore Dibër** informon se për **341** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 8- **Zyra Përmbarimore Durrës** informon se për **5586** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 9- **Zyra Përmbarimore Sarandë** informon se për **910** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 10- **Zyra Përmbarimore Korçë** informon se për **300** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 11- **Zyra Përmbarimore Pogradec** informon se për **250** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 12- **Zyra Përmbarimore Tropojë** informon se për **59** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 13- **Zyra Përmbarimore Përmet** informon se për **139** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 14- **Zyra Përmbarimore Krujë** informon se për **142** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 15- **Zyra Përmbarimore Pukë** informon se për **76** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 16- **Zyra Përmbarimore Lezhë** informon se për **600** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 17- **Zyra Përmbarimore Elbasan** informon se për **468** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.
- 18- **Zyra Përmbarimore Shkodër** informon se për **509** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

19- Zyra Përmbarimore Kukës informon se për **341** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

20- Zyra Përmbarimore Fier informon se për **315** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

21- Zyra Përmbarimore Gjirokastrë informon se për **500** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

22- Zyra Përmbarimore Tiranë informon se për **2460** tituj ekzekutivë nuk janë zbatuar urdhrat e sekuestros nga ASHK dhe DPSHTRR.

Në total, sipas informacioneve të përcjella nga zyrat, rezultojnë të pazbatuar **15,101** urdhra sekuestro për periudhën Janar - Dhjetor 2024.

4.3 Bashkëpunimi me organizatat kombëtare/ndërkombëtare dhe donatorët

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nuk ka zhvilluar bashkëpunime kombëtare/ndërkombëtare apo projekte në partneritet me donatorë. Megjithatë, ky mbetet një drejtim me rëndësi strategjike për forcimin e kapaciteteve institucionale, shkëmbimin e përvojave dhe harmonizimin e praktikave me standardet më të mira evropiane në fushën e përmbarimit.

Në vijimësi, synohet intensifikimi i marrëdhënieve me organizata ndërkombëtare, rrjete profesionale dhe partnerë zhvillimi, në funksion të rritjes së profesionalizmit dhe modernizimit të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

4.4 Raportimet e DPP-së në kuadër të strategjive ndërsektoriale

Në funksion të angazhimeve ndërinstitucionale për zbatimin e reformës në drejtësi, gjatë vitit 2024 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka vijuar raportimin periodik në kuadër të strategjive ndërsektoriale pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Raportimi është realizuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara në dokumentet strategjike për sistemin e drejtësisë dhe ka pasqyruar progresin, sfidat dhe masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të reformës, sidomos në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Ky proces ka kontribuar në vlerësimin e ecurisë institucionale dhe në identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme në funksion të përmirësimit të shërbimeve përmbarimore dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit është përcjellë kontributi për Nënkomitetin JFS dhe Piketat e Ndërmjetme, i cili do të bëhej pjesë e raportit mbi Fundamental Rights (property rights, rights of minorities and media), lidhur me çështjet përmbarimore që lidhen me pronësinë, si dhe masat e zbatuara për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura, lidhur me pronësinë (property cases backlog).

Referuar të dhënave statistikore të përcjella nga 22 Zyrat Vendore Përmbarimore rezulton se :

- **Çështje përmbarimore në total që lidhen me pronësinë (njohje pronar, regjistrim prone, lirim dorezim sendi të paluajtshëm)** në ekzekutim deri në Dhjetor 2024 janë 237 dosje.
- Çështje përmbarimore që lidhen me pronësinë të ekzekutuara në vitin 2024 janë 26 dosje përmbarimore.
- Çështje përmbarimore që lidhen me pronësinë të pezulluara më vendim gjykatë janë 9 dosje përmbarimore.

Arsyet e mosekzekutimit të çështjeve përmbarimore që janë me afate procedurale të plotësuar (të mbartura) janë :

- Mosbashkëpunimi i IKMT dhe IMT me mjete të nevojshme dhe fuqi punëtore për prishjen e një objekti që lidhet me « lirim dorëzim sendi të paluajtshëm ».
- Mosbashkëpunimi i palëve kreditore për të parapaguar shpenzimet përmbarimore përkatëse në bazë të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet kur nevojitet përcaktim përfaqësues ligjor se pala debitoare nuk gjendet, aplikimi në e - albania pranë ASHK, pagesa e ekspertit topograf për përcaktimin e piketave.
- Pezullimi i veprimeve përmbarimore me vendime të ndërmjetme të gjykatës së rrethit, në rastet kur palët kryejnë kundërshtim veprimesh përmbarimore.
- Pezullim me kërkesë të vet palës kreditore në bazë të nenit 615/b të Kodit të Procedurës Civile, pasi palët arrijnë në një marrëveshje me njëri tjetrin jashtë zyrave përmbarimore.
- Mosnjohim i palës debitoare nëpërmjet shërbimit postar, pasi shpesh zarfi kthehet me shënimin: adresë e pasaktë ; adresë e pamjaftueshme ; larguar.
- Zvarritje e seancave gjyqësore që lidhen me procedurat përmbarimore si përshembull : për përcaktim përfaqësues ligjor apo kundërshtim veprimesh përmbarimore.
- Mosregjistrim i vendimeve gjyqësore nga ana ASHK pasi për pasurinë e paluajtshme, kur ka mbivendosje apo objekti ka pësuar transaksione më të hershme, duke u kaluar palëve të treta.
- Mosbashkëpunimi i palës kreditore për të vënë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të Ligjit nr. 171/14, për përfundimin e procedurave të kalimit të tokave bujqësore të ish NB në pronësi të përfituesve dhe VKM nr. 337, datë 22.04.2015.
- Mosekzekutim nga ana e palës debitoare. Në vijim nga përmbaruesi gjyqësor është aplikuar sanksion ligjor si gjobë për pengesë në ekzekutim të vendimit gjyqësor.

Për sa më sipër, me qëllim uljen e numrit të çështjeve përmbarimore me afate procedurale të plotësuar që lidhen me pronësinë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit vlerëson se masat që duhet të ndërmerren në vazhdimësi janë :

- Rritja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, si IKMT, ASHK etj.
- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike, nëpërmjet rritjes së numrit të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.
- Trajnimi i vazhdueshëm i përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, nëpërmjet organizimit të trajnimeve për përmbaruesit, duke përfshirë teknikat më të mira për zbatimin e vendimeve gjyqësore.
- Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, si dhe akteve nënligjore sa i përket ekzekutimit të detyrueshëm, me qëllim thjeshtimin e procedurave administrative, eliminimin e burokracive të panevojshme.

Në tabelën IMB e cila përmban të identifikuar Piketat e Ndërmjetme të zërthyer në hendeqe kritike (Critical Gaps) sipas takimeve tematike shpjeguese, për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit janë parashikuar **masa për periudhën 2025 – 2030**, me tregues:

- Raporti i dosjeve të ekzekutuara nga përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë ndaj dosjeve të regjistruara (%) – Rezultatet e pritshme: Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror do të ekzekutojë 30% më shumë dosje se ato të ekzekutuara në vitin 2024.

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është përcjellë informacion se referuar Planit të Veprimit dhe Pasaportës së Indikatorëve, në kuadër të **Strategjisë Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030**, rezulton se për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit nuk është parashikuar asnjë aktivitet për t'u realizuar për vitin 2024, por janë parashikuar aktivitete për afatin kohor në periudhën 2025-2030.

Në kuadër të zbatimit të **Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2024 – 2030** nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit është përcjellë kontributi për periudhën Janar – Dhjetor 2024, si më poshtë:

- **Aktiviteti 3.1.6.1. Kryerja e një analize mbi identifikimin e nevojave për përmbartues gjyqësorë shtetërorë dhe plotësimin e vendeve vakante:** Nga DPP është evidentuar nevoja për plotësim të 7 vendeve vakante për përmbartues gjyqësor. Realizuar.
- **Aktiviteti 3.1.6.2. Plotësimi i vakancave në referim të gjetjeve të analizës:** Është mundësuar ndjekja e procedurës dhe plotësimi i 6 vendeve vakante nga 7 të publikuara për përmbartues gjyqësor shtetëror.
- **Aktiviteti 3.1.6.3. Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim vazhdues dhe trajnim i specializuar sipas fushave:** Urdhri nr. 432, datë 30.06.2023 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve për përmbartues gjyqësor". Urdhri nr. 333, datë 18.06.2024 "Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbartuesit gjyqësor, shtetëror".
- **Aktiviteti 3.1.6.4. Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbartimor gjyqësor lidhur me procedurat e ekzekutimit":** I përealizuar.
- **Aktiviteti 3.1.6.5. Rishikimi dhe përditësimi i programeve të trajnimit të punonjësve të shërbimit të përmbartimit gjyqësor për procedurat e ekzekutimit:** Me miratimim e urdhrave për programin e trajnimit, do të procedohet në vijim rishikimi dhe përditësimi i tyre.
- **Aktiviteti 3.6.14.1. Kontrollë të rregullta të shërbimit përmbartimor dhe publikimi i vendimeve me qëllim rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së publikut:** Janë kryer inspektime pranë 22 Zyrave Vendore Përmbartimore në zbatim edhe të planit vjetor të inspektimeve. Kostoja në buxhet është 141,920 lekë për vitin 2024 "dieta udhëtimi". Realizuar.
- **Aktiviteti 3.6.14.2. Organizimi i trajnimeve të rregullta për përmbartuesit mbi ndryshimet ligjore, etikën profesionale dhe teknologjitë e reja :** Në proces. I përealizuar.

- **Pasaporta e Treguesve : Raporti i dosjeve të ekzekutuara nga përmbauesit gjyqësorë shtetërorë me dosjet e regjistruara (%) për vitin 2024.**
 - Dosje përmbaimore në total janë 55,201,
 - dosje në ekzekutim janë 44527,
 - dosje të ekzekutuara janë 7012,
 - dosje të pushuara janë 1611,
 - dosje të refuzuara janë 100,
 - dosje të pezulluara me vendim gjyqësor janë 279,
 - dosje të transferuara janë 1131,
 - dosje të pushuara me 616/c janë 541.
- **Aktiviteti 3.1.6.1 Kryerja e një analize mbi identifikimin e nevojave për përmbauesë gjyqësorë shtetërorë dhe plotësimi i vendeve vakante.** Me Urdhër nr. 447, datë 10.7.2023 “Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbaimore Gjyqësor Shtetëror” të Ministrit të Drejtësisë, është urdhëruar:
 - Numri i përgjithshëm i përmbauesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbaimore Gjyqësor Shtetëror, të **jetë 144.**
 - Përgjithësisht, për vitin 2023, numri i përgjithshëm i Shërbimit Përmbaimore Gjyqësor Shtetëror të **jetë 78.**
- **Aktiviteti 3.6.14.1** Kontrollë të rregullta të shërbimit përmbaimore dhe publikimi vendimeve me qëllim rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së publikut.
- **Çfarë problematikash vihen re nga inspektimet që kryhen dhe a publikohen raportet e inspektimit?**

Referuar inspektimeve të kryera pranë 22 Zyrave Vendore Përmbaimore, evidentohen problematika si më poshtë:

- Numër shumë i lartë i dosjeve përmbaimore të ngarkuara për ekzekutim një përmbauesi gjyqësor. Po të marrim në referencë Zyrën Përmbaimore Tiranë, një përmbaues gjyqësor ka mesatarisht 1500 dosje përmbaimore në ngarkim për ekzekutim.
- Mosrespektim afatesh procedurale për shkak të ngarkesës së lartë të dosjeve përmbaimore në ekzekutim.
- Mosekzekutim i vendimeve gjyqësore për shkak të mosbashkëpunimit nga ana e IKMT për dosjet përmbaimore me objekt – lirim dorëzim sendi, prishje objekti, si dhe moszbatimi i urdhrave të sekuestros konservative nga ana e ASHK dhe DRSHT, pasi nga ana e tyre kërkohet pagim i një tarife aplikimi online, ndërkohë që numri më i lartë i dosjeve përmbaimore është me palë shteti kreditor.
- Praktikë përmbaimore jo e unifikuar për shkak të boshllëkut ligjor dhe mosparashikimeve konkrete në ligj apo akteve nënligjore lidhur me një procedurë përmbaimore të caktuar.

Raportet e inspektimeve nuk publikohen, pasi në to janë të pasqyruara të dhëna të dosjeve përmbaimore, të palëve dhe vendimeve gjyqësore, por në bazë të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e

Shërimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, vendimet për arkivimin apo fillimin e një hetimi disiplinor janë njoftuar pranë ankuesit, i cili ka kërkuar fillimin e një procedure disiplinore ndaj një përmbartuesi gjyqësor.

1. Buxheti i shpenzuar për aktivitetin 3.6.14.1 është 141,920 lekë për vitin 2024 (dieta udhëtimi).
2. Realizimi i aktivitetit është 100 %, pasi janë kryer të gjitha inspektimet e parashikuara në Planin Vjetor të Inspektimeve për vitin 2024.

Nga Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit është përcjellë informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, Integritit dhe Negociatave, pranë Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me kontributin për periudhën Janar – Dhjetor 2024, në kuadër të zbatimit të **Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026**, si vijon:

- **Aktiviteti 2.1.3.5 Monitorimi i zbatimit të përmirësimeve ligjore dhe të ekzekutimit të vendimeve të çështjeve të adresuara në masë :** Për vitin 2024, 8619 janë çështje me objekt « pension ushqimor », nga të cilat 72 janë ekzekutuar dhe 8489 janë në ekzekutim të vazhdueshëm, 38 të transferuara, 3 pezulluar me vendim gjykatë, 10 pushuar 616/b, 3 pushuar 616/c, 1 pushuar dhe 3 çështje refuzuar. Në proces.
- **Aktiviteti 2.2.1 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe formimit vazhdueshëm nga secili institucion që punon me ose për fëmijët duke specifikuar trajnimet sipas fushave të përcaktuara në KDPM (neni 26 KDPM) dhe bërja transparente e tyre në faqen zyrtare të institucionit :** Urdhri nr. 432, datë 30.06.2023 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve për përmbartues gjyqësor". Urdhri nr. 333, datë 18.06.2024 "Për miratimin e programit të formimit vazhdueshëm për përmbartuesit gjyqësor, shtetëror". Realizuar.
- **Aktiviteti 2.2.1.3 Takime periodike të institucioneve dhe partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë trajnuesë në fushën për drejtësi për fëmijët dhe shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin (çdo gjashtë muaj) :** Së bashku me Urdhrin e Psikologut është realizuar një ëorkshop me temë "Sfidat e shërbimit psikologjik në Shqipëri pas ngritjes së Urdhrit të Psikologut". Në proces.
- **Aktiviteti 2.2.10.2 Trajnimi vazhdueshëm i punonjësve të shërbimit përmbartimor gjyqësor për të drejtat e fëmijëve :** Me miratimin e programit të trajnimit fillestar dhe urdhrave, do të procedohet me garantimin e trajnimeve për përmbartuesit gjyqësor.
- **Aktiviteti 3.2.5.2 Krijimi i mjediseve miqësore për fëmijën në zyrën e përmbartimit gjyqësor Tiranë :** Në proces ndjekjeje krijimi i ambienteve miqësore për fëmijë për Zyrën Përmbartimore Tiranë. I parealizuar.
- **Aktiviteti 3.2.5.3 Përcaktimi në të gjitha zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor të punonjësve të dedikuar dhe të specializuar për të drejtat e fëmijës :** Janë miratuar programet e trajnimit fillestar dhe vazhdueshëm për përmbartuesit gjyqësor si dhe është evidentuar nevoja e psikologëve në strukturën e shërbimit dhe është në proces realizimi.

- **Aktiviteti 3.3.1.1 Vlerësimi i nevojave për burimet njerëzore të nevojshme dhe rishikimi i organigramës së çdo institucioni që punon me dhe për fëmijët :** Nga DPP është evidentuar nevoja për shtimin e organikës si dhe është bërë propozimi përkatës. Realizuar.
- **Aktiviteti 3.3.1.2 Rishikimi i buxhetit të çdo institucioni në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve mbështetëse miqësore për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin :** Me miratimn e programit vazhdues dhe fillestar për përmbaruesit gjyqësor, sigurisht që në vijim do të planifikohet në buxhet edhe sigurimi i trajnimit të tyre. Në proces.

5. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I SHPGJSH

5.1 Drejtimi administrativ i Zyrave Vendore Përmbarimore

Në kuadër të garantimit të duhur të drejtimit administrativ të zyrave vendore përmbarimore janë marrë masat përkatëse sa i përket evidentimit si dhe propozimeve konkrete drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për sigurimin e drejtimit të zyrave vendore në përputhje me dispozitat e ligjit organik në fuqi.

Gjithashtu, për gjatë këtij viti, kemi krijuar të vakancave në detyrën e Kryetarit të Zyrës, në zyrat vendore përmbarimore, si më poshtë:

1. Në Zyrën Përmbarimore, Kukës, është krijuar vakancë e përkohshme në detyrën e kryetarit për shkak se Kryetari i Zyrës ka qënë përkohësisht me raport për barrë lindje;
2. Në Zyrën Përmbarimore, Lezhë, Kryetari i Zyrës është larguar nga detyra e Kryetarit për shkak të plotësimit të moshës dhe përfitimit të pensionit të pleqërisë;
3. Në Zyrën Përmbarimore Durrës, Kryetari i Zyrës është larguar nga detyra e me kërkesën e tij për arsye personale shëndetësore.

Në këto kushte, me qëllim garantimin e drejtimit administrativ të zyrave bazuar në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr. 8, datë 2.2.2023 *‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror’*, është mundësuar caktimi i 4 (katër) përmbaruesve gjyqësorë në detyrën e Kryetarit të Zyrës Përmbarimore, si më poshtë:

- caktimi i përkohshëm i përmbaruesit gjyqësor në ushtrimin e detyrave të Kryetarit të Zyrës në Zyrën Përmbarimore Kukës;
- caktimi i përmbaruesit gjyqësor në ushtrimin e detyrave të Kryetarit të Zyrës në Zyrën Përmbarimore Durrës, për shkak të vakancës në pozicionin të Kryetarit të Zyrës të krijuar për shkak të largimit nga kjo detyrë për arsye shëndetësore;
- me largimin nga detyra e përmbaruesit gjyqësor si dhe e kryetarit të zyrës për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie të Kryetarit të Zyrës në Zyrën Përmbarimore Lezhë, për të garantuar përkohësisht drejtimin e kësaj zyre është caktuar një përmbarues gjyqësor;
- Me plotësimin e vendit vakand për përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore, Krujë, si dhe ndodhur në kushtet ku organika e kësaj zyre ka vetëm 1 (një) Përmbarues Gjyqësor/Kryetar zyre është mundësuar caktimi i po këtij përmbaruesi që të kryejë edhe detyrat e drejtimit administrativ të zyrës.

5.2 Transferime të përkohshme

Në kuadër të garantimit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë dhe përmbushjen objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme për shërbimin, në zyrat të cilat janë karakterizuar nga një ngarkesë e lartë çështjesh përmbimore, evidencave të punës për përmbarues gjyqësor dhe problematikës së krijuar për shkak të vakancave, është mundësuar transferimi i përkohshëm i 2 (dy) përmbaruesve gjyqësorë për nevoja pune.

Kështu në vlerësim të situatës, është mundësuar:

1. transferimi i përkohshëm i përmbaruesit gjyqësor të Zyrës Përmbimore Elbasan në detyrën e përmbaruesit gjyqësor në Zyrën përmbimore Kavajë.
2. transferimi i përkohshëm i përmbaruesit gjyqësor në Zyrën Përmbimore Lushnjë në detyrën e përmbaruesit gjyqësor në Zyrën Përmbimore Durrës.

Gjatë këtij viti, është mundësuar rikthimi i dy përmbaruesve që kanë qënë të komanduar në detyrën e përmbaruesit dhe të kryetarit të Zyrës në zyrat vendore përkatëse me rënien e shkakut ligjor, kështu:

- përmbaruesi gjyqësor i Zyrës Përmbimore Lezhë, i cili ka qënë i komanduar nga Dhjetori i vitit 2022 - 30.12.2024 në detyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe njëkohësisht të Kryetarit të Zyrës në Zyrën Përmbimore Krujë, me plotësimin e vendit vakand është urdhëruar shfuqizimi i urdhrit të komandimit dhe rikthim i tij në detyrën e përmbaruesit gjyqësor në Zyrën Përmbimore Krujë;
- po ashtu me plotësimin e vendit vakand për përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbimore Tiranë është urdhëruar shfuqizimi i urdhrit të komandimit dhe rikthimi i përmbaruesit gjyqësor të komanduar në detyrën e përmbaruesit pranë Zyrës Përmbimore Fier.

5.3 Transferime të perhershme

Për vitin 2024 nuk rezulton të jetë kryer asnjë transferim i përhershëm i përmbaruesve gjyqësorë shtetëror.

5.4 Rekrutimi i Përmbarueseve Gjyqësor Shtetëror dhe punonjësve me Kod Pune

Gjatë Janar - Qershor 2024, janë marrë masat në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi për plotësimin e organikës në çdo zyrë vendore përmbimore, duke kryer lëvizjet e nevojshme brenda shërbimit për të garantuar shërbim për shtetasit, duke plotësuar vendet vakante të personelit administrativ në nivel qendror dhe vendor apo duke ndjekur procedurat përkatëse për shpalljen e vendeve vakante për përmbarues gjyqësor. Kështu është mundësuar shpallja e 7 vendeve vakante për përmbarues gjyqësor, konkretisht 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Tiranë, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Durrës, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Dibër, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Shkodër, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Lezhë, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Krujë dhe 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbimore Elbasan. Ndjekja e procedurave përkatëse ligjore dhe plotësimi i 6 (gjashtë) vendeve vakante. Kështu, është mundësuar plotësimi i vendit vakand për përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbimore Elbasan, Dibër, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Krujë.

Me largimin e një përmbaruesi gjyqësor në Zyrën Përmbimore Kukës, për shkak të plotësimit të moshës dhe përfitimit të pensionit të pleqërisë, si dhe mosplotësimit të vendit vakand të shpallur për Zyrën

Përmbartimore Durrës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë për shpalljen e këtyre dy vendeve vakante me qëllim plotësimin e tyre.

Për shkak të natyrës së veçantë të punës së Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror, i cili nuk operon vetëm me fondet buxhetore, por ka edhe ndjekjen e llogarisë përmbartimore, vënia në funksionim e 21 (njëzet e një) zyrave vendore përmbartimore si njësi shpenzuese si dhe Specialistit të Financës si nëpunës zbatues e domosdoshme për organizimin në përputhje me rregullat ligjore të zyrës vendore përmbartimore, siç parashikohet në ligjin nr. 8, datë 2.2.2023 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”* (zyrat përmbartimore pranë çdo rrethi gjyqësor përbëhen nga: a) kryetari i zyrës; b) përmbartuesit gjyqësorë; c) personeli administrativ dhe teknik. 2.Çdo zyrë përmbartimore është person juridik dhe ka vullnet vet) në strukturën organike të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 222, 14.12.2023, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 21, datë 25.10.2016 *“Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”*, është mundësuar ndjekja e gjithë procesit duke garantuar konfirmimin 21 (njëzet e një) zyrave vendore përmbartimore si njësi shpenzuese, çeljen e kodeve të institucionit për 21 (njëzet e një) zyrat vendore), konfirmimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues për 21 (njëzet e një) zyrat vendore përmbartimore, dhe për rrjedhojë zgjidhjen e problematikës së krijuar me zbatimin e ligjit nr. 87/2019, për lëshimin e faturave elektronike të fiskalizuar si dhe garantimin e mbarëvajtjes së punës dhe efikasitetit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror në funksion të përmbushjes së misionit të tij, atë, të realizimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Në zbatim të ligjit nr. 08, datë 02.02.2023 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”*, VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, shkronja (ç), pika 2, pika 9 dhe pika 10, shkronja (a), në Strukturën Organike të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 222, datë 14.12.2023, ku evidentohet ndryshim në emërtimin e disa prej pozicioneve mbështetëse, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024 në njësitë e qeverisjes qendrore”*, ku për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, për vitin 2024, ka patur të miratuar 4 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme dhe kohëzgjatje 6/orë në ditë si dhe vlerësuar që në organikën e shërbimit ka pozicione pune që kryhen në kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin e punonjësve, po ashtu, ka edhe punonjës me kontratë të përkohshme që kryejnë punë në kushte të vështira dhe të dëmshme, **është mundësuar ndjekja e procedurës përkatëse dhe përcaktimi i miratimi i shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për vendet e punës** në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

Referuar qëllimit dhe objektit që ka patur dhe duhet të ketë ligji organik i shërbimit, që është rritja e cilësisë së ekzekutimit, nëpërmjet dispozitave përcaktuese që garantojnë rritje të performancës profesionale të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, trajtim financiar në masë të mjaftueshme me natyrën, përgjegjësitë e funksionit dhe shkallën e vështirësisë, si dhe garantojnë një kuadër të drejtash për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë, që synon një shërbim përmbartimor gjyqësor, të përgjegjshëm, profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit, si dhe për të mundësuar garantimin e të drejtës së ushtrimit të funksionit të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, në detyrë, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri organik, dhe të emëruar në përputhje të plotë me kriteret e ligjit të kohës, me vënien në zbatim të tij është konstatuar në kohë dhe përcjellë për në Ministrinë e Drejtësisë vlerësimi me propozimet konkrete mbi efektet dhe pasojat e

implementimit të ligjit të ri organik si dhe të VKM - në nr. 325, datë 31.05.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*, i ndryshuar, me qëllim që të garantohet e drejta e ushtrimit të funksionit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në detyrë, që preken nga zbatimi i këtij ligji.

Janë emëruar në përputhje me ligjin organik dhe dispozitat e Kodit të Punës në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror 10 (dhjetë) nëpunës, konkretisht:

- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbarimore Kavajë;
- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbarimore Dibër;
- 1 (një) Specialist Protokolli në Zyrën Përmbarimore Tiranë;
- 1 (një) Specialist Arkive në Zyrën Përmbarimore Tiranë;
- 1 (një) Specialist, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
- 1 (një) Shofer, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
- 1 (një) Ftues, punonjës me kontratë vjetore në Zyrën Përmbarimore Tiranë;
- 1 (një) Operator, punonjës me kontratë vjetore në Zyrën Përmbarimore Tiranë;
- 1 (një) Nëpunës informacioni, me kontratë vjetore Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
- 1 (një) Mirëmbajtës, me kontratë vjetore Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;

Janë larguar nga detyra 8 (tetë) nëpunës të administratës së shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, si më poshtë:

- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbarimore Dibër;
- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbarimore Kavajë;
- 1 (një) Specialist Protokolli në Zyrën Përmbarimore Tiranë;
- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbarimore Lezhë;
- 1 (një) Specialist, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
- 2 (dy) Shofer, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
- 1 (një) Nëpunës informacioni, me kontratë vjetore Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;

5.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit.

Për vitin 2024 rezulton se nuk është kryer asnjë trajnim i përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë apo punonjësve të administratës. Mungesa e trajnimeve pavarësisht parashikimeve në Ligjin nr. 8/2023 ka ndikuar në pamundësinë për përmirësim profesional të vazhdueshëm dhe për përditësimin me ndryshimet ligjore dhe praktikat më të mira në fushën përmbarimore etj.

Kjo evidentohet si një mangësi që kërkon adresim në objektivat e vitit 2025, për të garantuar rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

5.6 Përmbarusit në periudhë prove.

Gjati vitit 2024 është mundësuar plotësimi i vendit vakand për përmbarues gjyqësor në 6 (gjashtë) zyra vendore, Zyrën Përmbarimore Elbasan, Dibër, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Krujë dhe për rrjedhojë janë 6 (gjashtë) përmbarues gjyqësor në periudhë prove:

- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Elbasan;
- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Diber;
- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Lezhe;
- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Shkodër;
- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Tirane;
- 1(një) përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Kruje;

5.7 Procesi i vlerësimit fillestar dhe i vazhdueshëm i përmbaruesve gjyqësor, sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjt nr. 8./2023.

Për vitin 2024 nuk ka patur vlerësim për stafin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

5.8 Proceset gjyqësore

Sa i përket çështjeve gjyqësore janë ndjekur me përkushtim dhe prioritet 39 (tridhjetë e nëntë) çështje gjyqësore, me palë të paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, Ministria e Drejtësisë, nga të cilat 22 (njëzet e dy) çështje janë procese të fituara në shkallë të parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe për rrjedhojë në proces gjykimi, 5 (pesë) procese gjyqësore të humbura në shkallë të parë të gjykmës dhe 12 çështje gjyqësore janë në proces gjykimi në shkallë të parë.

6. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

6.1 E drejta e informimit

Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, çdo individ gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Sipas detyrimeve të parashikuara në ligjin nr 119/2014, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në regjistrin e posaçëm dhe trajtohet sipas dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit.

6.2 Kordinatori për të Drejtën e Informimit

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit gjatë vitit 2024 ka përmirësuar dhe përditësuar Programin e Transparencës të publikuar në faqen zyrtare të DPP. Gjithashtu, nga ana e DPP publikohen në faqen zyrtare Shpalljet për Vendet e Lira të punës, është i publikuar për aq sa është mundur legjislacioni përkatës, Regjistri i Kërkesave dhe Ankesave. Nga ana e DPP-së nëpërmjet adresës elektronike të Kordinatorit Për të Drejtën e Informimit përcillen te Komisioneri për të Drejtën e Informimit, çdo muaj Regjistri i Kërkesave dhe Ankesave të hyra në DPP, pa cenuar privatesinë e palëve apo të procesit të ekzekutimit.

Gjithashtu nga Kordinatori për të Drejtën e Informimit janë mbajtur dhe publikuar Regjistrat e Kërkesë/Ankesave të përcjella në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, regjistra të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Për vitin 2024, nuk janë paraqitur kërkesa për informim publik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

6.3 Komunikimi me masmedian

Është mundur monitorimi i mediave për lajmet që kanë të bëjnë me përmbartimin dhe përditësimi i faqes zyrtare elektronike të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit vetëm sa i përket- njoftimeve për vende vakante, rezultateve të testimit etj. Vlen të theksohet që referuar shkresës nr. 436 prot, dt. 2.02.2024 “Mbi evidentimin e nevojës për mbarëvajtjen e faqes zyrtare elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit”, nga specialisti i TIK është njoftuar që webi i institucionit është i ndërtuar në një version jashtë funksionit të tij, (end of life EOF) dhe është kërkuar marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e procedurës së mirëmbajtjes.

6.4 Rrjetet sociale. FC/INSTA

Gjatë vitit 2024 nuk ka patur publikime në rrjetet sociale zyrtare si Instagram apo Facebook. Promovimi i punës së shërbimit përmbartimor dhe informimi i publikut për çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore mbetet një fushë me potencial të pashfrytëzuar.

Për vitin 2025, synohet forcimi i pranisë institucionale proaktive në rrjetet sociale me qëllim rritjen e transparencës, ndërgjegjësimin e publikut dhe komunikimin efektiv me qytetarët.

6.5 Edukimi Ligjor si mënyrë komunikimi

Gjatë vitit 2024, nuk janë realizuar nisma apo aktivitete të posaçme në kuadër të edukimit ligjor të publikut nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit apo zyrave përmbartimore gjyqësore shtetërore.

Edukimi ligjor mbetet një mjet i rëndësishëm për forcimin e marrëdhënies mes qytetarëve dhe institucionit të përmbartimit, si dhe për informimin dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore dhe procesi i ekzekutimit të tyre.

Për vitin 2025, synohet të hartohen dhe të zbatohen programe apo materiale informuese me karakter edukativ, që do të shpërndahen përmes rrjeteve sociale, faqes zyrtare dhe në bashkëpunim me institucione të tjera publike.

7. PERFORMANCA FINANCIARE

7.1 Shpenzimet buxhetore. Realizimet buxhetore.

